

## STUDIM MBI NEVOJËN, STRUKTURËN DHE EFIKASITETIN E EDUKIMIT MJEDISOR NË SHQIPËRI

KOTORI P.<sup>1</sup>, MALOLLARI F.<sup>2</sup>.

<sup>1</sup>Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

<sup>2</sup>Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Kimisë  
Industriale dhe Mjedisore

### Përmbledhje

Ambjenti në vendin tonë është sektori më i penalizuar i krahasuar me sektorë të tjerë të mjedisit komunitar. Njohjet mbi ambjentin fillimisht si kudo, kanë kaluar në përgjithësi së bashku me lëndët e tjera të shkencave të natyrës. Në Universitetet shqiptare para viteve '90 nuk ka patur interes për të mësuar për probleme të ambjentit dhe kurset e shkencave të natyrës përfundonin vetëm me eskursione në muzetë e natyrës dhe parqet natyrore në mbarë vendin. Nga ky program i cunguar ka derivuar një varfëri drejt njohjes së problemeve ambjentale e cila është parësore në degradimin e pasurive natyrore në vendin tonë. Studimet sidomos në shkencat ambjentale kanë filluar pas viteve '90 fillimisht si disiplina të veçanta duke marrë modelin e shkollave anglo-saksone, franceze, italiane dhe duke j'u larguar programeve të Evropës Lindore. Fillimisht në harkun e viteve '92-95 lindën shoqatat e para ambjentaliste ku u reflektua dhe futja e lëndëve të tilla si Ekologjia, shkencave mjedisore si lëndë komplementare fillimisht, vetëm në degët e studimit të shkencave të natyrës. Këto vite janë karakterizuar me shtimin e përpjekjeve për ristrukturimin e kurseve universitare, shumë syresh të vjetëruara, duke atakuar nyjen kryesore atë të raportit të njeriut me ambjentin. Kanë qenë të paevitueshme debatet dhe konfliktet në drejtime të tjera të studimeve, me përkrahësit për një vision ndërdisiplinor të fenomeneve ambjentale.

### Abstract

Environment in our country is the most penalized sector compared with other Community sectors. The knowledge on the environment substantially, has generally gone along with other subjects of natural sciences. In Albanian Universities before '90, there was no interest in learning about the environmental problems and the courses of natural sciences were completed only with excursions to museums and natural parks across the country. Due to this uncompleted program, has derived the poverty, to recognize environmental problems which has resulted to degradation of the natural resources in our country. The studies in environmental sciences have started after the '90, firstly as a special discipline of high schools taking the Anglo Saxon, French and Italian models, being removed from East European programs. During '92-95, were founded the first environmental associations, which reflected the introduction of complementary subjects such as ecology and environmental sciences, initially only in the study programs of natural sciences. Recently years are characterized by increasing the efforts to restructure the undergraduate courses, many of them were old and attacked the main node of the human - environment ratio. Also were inevitable the debates and conflicts in the other areas of environmental studies, with supporters for an

interdisciplinary vision of environmental phenomena. Besides the absence of the specific programs in environmental sciences at universities, lack of environmental knowledge has been fed by misinformation. Based on convenient proposals for pollution and environmental damage are undertaken many initiatives, but are neglected or treated superficially the cases of environmental degradation, that only a researcher can perceive. Seeing in this context, were necessary the teaching programs to open a full course of environmental sciences. Only the university experience can touch the needs, different requirements for training and scientific controversies with certainty. Finally, we think that learning capacity as a result of the cultural level of students, their desire to receive information and the competence of the given information, may be the definition of the perception as a primary parameter of the course study.

**Fjalëkyçe:** Edukim mjedisor, ndotjet kimike, informacioni shkencor, ndërgjegjësimi publik, veprimi rehabilitues.

### **Hyrje**

Përpos mungesës së programeve të mirefillta të shkencave ambjentale nëpër Universitete, analfabetizmi ambjental ka qënë i ushqyer nga dezinformimi. Kjo situatë gjeti mbështetje dhe në mënyrën e komunikimit nëpërmjet shoqatave ambjentaliste praktikisht duke konkuruar edhe në kurse formimi, të privuara nga kualifikimi shkencor por kishin thjesht karakter njohës. Këta kanë operuar me besim por, jashtë kriterëve shkencore dhe të pa aftë për të vlerësuar në terren rezultatet. Shumë inisiativa të ndermarra janë bazuar në propozime të leverdisshme për ndotjet, për dëmet mjedisore por, janë lënë pas dore ose të trajtuara në mënyrë të percipitë raste të degradimit të ambjentit që vetëm një kërkues shkencor mund t'i perceptojë. Kështu janë ushtruar mjaft shoqata me një numër kursesh formimi për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambjentit me fonde donacione të huaja, por edhe me fonde publike. Parë nën këtë kontekst, lindi nevoja e programeve didaktike për formimin e kurseve të plotë të shkencave ambjentale (Bejtullahu, Bicaj, Rrustemi. 2011). Vetëm eksperiencia universitare, mund të pajtojë nëvojat, kërkesat e ndryshme dhe kundërshtive të formimit shkencor me saktësi dhe duke penalizuar vulgaritetin (Mustafa, 2007).

### **Materiali dhe metodat**

Nevojat për informacion për ambjentin, vijnë si nga sektori social, që kërkon një spektër të gjërë të argumentave që, lidhen me ndryshimet klimaterike, ndotjet, kontaminimet në zinxhirin ushqimor të gjallesave, bioestetikën, demografinë etj ashtu edhe nga studentë që përfshihen në procesin e të studjuarit të shkencave ambjentale në tërësi. Ky publik heterogjen, presupozon disponibilitetin e stafit akademik të cilet, duhet të jenë njohës të mirë të shkencave respektive dhe mbi të gjitha të kenë aftësi për të gjetur lidhje të përbashkëta të nocioneve dhe koncepteve të ndryshme të këtij publiku. Pikërisht kjo është karakteristika e didaktikës së shkencave ambjentale, të cilat komportojnë strategji të komunikimit dhe të nxënimit të ndryshme, sipas tipit dhe argumentit të trajtuar dhe

kapacitetit të kuptimit nga publiku. Kapaciteti i të nxënit, rezultante e nivelit kulturor të studentëve, dëshira e tyre të pranojnë informacion dhe kopetenca e informacioneve që jepen, mund të jene definim i perceptimit si një parametër primar i studimit të kursit. Variablet që determinojnë suksesin e kursit të shkencave ambjentale, mund të përmbliidhen si

- A) Interes personal.
- B) Pasuria e informacionit të studentëve.
- C) Bashkeveprimi i nocioneve të ndryshme (kultura ).
- D) Rezistenca në pagesën për informacionin nga jashtë.

Në se mund të tentojme të eksperimentojmë një rezultat potencial të një kursi didaktik nëpërmjet relacionit  $Ri = f(ip, q, c, re)$

ku Ri është perceptimi ose kapaciteti i të nxënit (akumulim i informacionit)

$ip$  - Interes personal.

$q$  - Pasuria e informacionit të studentëve,

$c$ - Bashkeveprimi i nocioneve të ndryshme (kultura ).

$re$ - Rezistenca e akumulimit të informacionin nga jashtë.

Ne funksion të vlerave të ketij funksioni mund të dallojme shkalle të ndryshme të rezultatit të marre.

Rezistenca  $re$ , për akumulimin e informacionit mund të jetë ne kundërshti me interesat personale  $ip$  ose, kundërshtia varet nga vlera e përmbajtjes së informacionit prezent, i cili konkuron me informacionin e ri që merret (Kose, Akkus, Gezer, 2014). Vështiresitë lindin nga fakti që, ndërmjet termave të ndryshëm, stabilizohen veprime dhe kundërveprime (pozitive dhe negative), prej të cilave rritja e vlerës së një variabli shkakton ndryshimin e vlerave të variableve të tjerë. Disa prej tyre kanë varesi lineare por, pjesa më e madhe, janë në relacione jo lineare dhe japin rezultate të paparashikuara (Hyseni & Matthies, 2011). Mësim-dhënia kërkon të maksimizojë në mënyre adeguate interesat personale  $ip$ , në vlera te tilla që të rritë vleren e  $re$ , duke integruar pra, informacionin në një vizion gjithë përfshirës; të tilla objektiva i dedikohen përparësisë së didaktikës, puntualitetit të lidhjes se koncepteve egzistuese me koncepte të ndryshëm, që në analize të fundit cojnë në atë “ të bërit kulturë”. Është pikërisht kompleksiteti i sistemit didaktik, që e bën të mësuarit jo një teknikë por një art. Aspekti më i spikatur i Shkencave Ambjentale është që ato, më tepër se homogjenizimin e nocioneve, rezultojnë në asocimin e koncepteve të ndryshme dhe sic duket të palidhura. Nga integrimi i shumë koncepteve të

ndryshme lind dhe vizioni i olistikës, karakteristike e Ekologjise dhe e kategorive të shkencave sociale.

### **Analiza e raportit staf akademik –studentë**

Le të bëjmeë një egzaminim më të hollesishëm të niveleve të përshkruara. Eksperienca e fituar këto vite lejon të individualizojmë disa kategori të studentëve në funksion të mungesës së kulturës dhe perceptushmërisë (Unal, 2014; Bancheva, 2015), (aftësisë për të mësuar). Mund të rendisim kategoritë e potencialeve të studenteve si:

1. Niveli bazë, niveli zero i karakterizuar nga të qënit jashtë problemeve ambjentale dhe nga injoranca totale ndaj fenomeneve të natyrës. ( $rd = 0$ ,  $ic = 0$ ,  $ip$  maksimale,  $re$  minimale). Aftësia për të mësuar është maksimale.
2. Niveli mesatar i ulët i njohjes së Ekologjise në tëresi dhe për me tepër, edukim nga mjete të komunikimit me masat dhe ndikimeve skollastike.  $rd$ ,  $ic > 0$ ,  $re$  e lartë.
3. Niveli mesatar i lartë, fortësisht të kondicionuar nga një interes personal i lartë dhe nga pjesmarrja në shoqata ambjentaliste ( $rd$ ,  $ic > 0$ ,  $re$  e lartë). Në rastet e rritjes së rezistencës ndaj pagesave të informacionit shkencor, aftësia për të mësuar është minimale.
4. Niveli i lartë i njohurive, i cili presupozon një mbështetje teorike dhe eksperimentale nën udhëheqjen e ekspertëve dhe specialistëve ( $rd$ ,  $ic$  të larta,  $re$  minimale). Aftësia për të mësuar varet nga kualiteti i kurseve.

### **Rezultatet dhe diskutime**

#### **Niveli Bazë**

Ky nivel përfshin një bashkësi të gjere dhe heterogjen që shkojnë te nxënësit e sistemit parauniversitar, ose të përshkruara në kurse profesionale të guidave të natyrës nga zyrtarë të tjerë. Didaktika e të edukuarit është vecanërisht e vështirë dhe ballafaqohet rast pas rasti, duke bërë zgjedhje, nga publiku dhe mjetet më imediate të informacionit, duke moduluar një strategji të komunikimit për të kontrolluar feedback-un. Variabli që ndërhyt në këtë rast, është shkalla e maturisë dhe interesat personale. Kjo e fundit varet nga individi, luhet nga një kurs në tjetrin dhe nga kategoria sociale dhe në pjesën më të madhe i besohet kapacitetit të mesuesit. Përdorimi i një termiologjie të specializuar, vështrësia e argumentimit dhe bezdisja e ndërhyrjeve mund të tentojnë të zerojnë sasinë e informacionit të asimiluar ose me keq, mund të tentojnë të peshkohet drejt tematikave ambjentale. Është e nevojshme të stimulohet kurioziteti dhe të inkurajohet një dialog interaktiv. Është e rëndësishme ti drejtohem fenomenëve të dukshme, situacioneve konkrete të aktualitetit. Eksperienca e praktikave duhet të procedojnë te teoria, dhe kjo e fundit duhet të integrojë eksperiencën.

Instrumentet esenciale janë puna konkrete dhe eskursionet në natyrë. Ushtrimi në laboratore të mikrogjallesave të reja dhe observim direkt i gjallesave, ndërtimi i erbariumeve, i gjallesave të ujit dhe të tokës janë shumë efikase për një kohe të gjatë. Mbi këtë princip duhet bazuar didaktika e kurseve për zhvillimin e kultivimin e gjallesave të natyrës dhe guidat natyrore. Këto kurse për të rinjtë, të ardhur rishtaz, japin rezultate të kënaqëshme dhe janë të qëndrueshme në koshiencën e tyre; nga ana tjetër kërkojnë një impenjim kolektiv, një zgjedhje me të mirë nga tutorët dhe një sforcio ekonomike të ndjeshme. Këto janë edhe si një test prove dhe për lektorët, e cila kërkon një eksperience pas universitare. Universiteti duhet të trajtojë të tilla angazhime me besim në to, pa llogaritur kontot e tyre e cila, është shumë e rëndësishme për të rritur rolin social të Universitetit.

### **Niveli i dytë**

Ky nivel prezantohet në mënyre tipike nga mësues të institucioneve humane, që karakterizohen nga një impenjim kultural dhe civil, por me një informacion aproksimativ, e provuar nga teste shkollore dhe mjete të informacionit dhe fortësisht të kondicionuar nga besimi fetar i tyre dhe sensi i qytetërimit të tyre. Është përhapur një paragjykim i fortë që tenton të bëjë të ngjashme “mbetjen” dhe “ndotjen” duke i kthyer këto të fundit në terma për cdo dëm ambjental. Një prirje pozitive mund të arrihet vetëm duke rinovuar shprehitë (sjelljet) kulturore ndaj elementëve të vecuar.

### **Niveli i tretë**

Është ai i përfaqësuesve tipikë të shoqatave të mbrojtjes, të lidhura fort me motive personale dhe të ngjitura nga principe konservatore dhe që rihedhin çdo informacion, që nuk është konform interesave të lidhura me militantët e tyre. Pikërisht në besnikërinë dhe sigurinë e ideve të tyre, këta janë elementët më të qëndrueshëm dhe më të papërshkueshëm nga futja e informacioneve të reja, njerëz që përfaqësojnë anën e kundërt të asaj që është prezente. Prirja për të filluar është minimumi dhe kërkon një sforcio të madhe për të arritur rezultate të mira.

### **Niveli i katërt**

Është ai i të diplomuarve në degë speciale dhe të diplomuarve me eksperiencë në punë me tema ekologjike. Prirja, aftësia për të mësuar, varet nga zgjatja në kohë e kurseve. Është pa dyshim më e thjeshta nga ana didaktike, e cila nuk implikon mjetet e komunikimit, vecanërisht duke përdorur një gjuhë e ndryshme nga ajo shkencore por, bazohet mbi të gjitha mbi kualitetin e informacionit dhe nga prurjet e reja të eksperiencës.

Një hallkë e rëndësishme meritojnë eskursionet dhe ekspeditat në det të cilat, janë instrumenta me një efikasitet të gjatë, për të kuptuar jetën e ambjentit në të

gjitha nivelet didaktike. Realizimi i tyre bëhet më mirë kur ato shoqërohen dhe me të rejtat e shkencës. Suksesi i tyre është i sigurtë, kur ato bëjnë të mundur të formojnë të dhena të këndëshme dhe japin për këto studime imazhe jo të mërzhitëshme. Në fund të fundit, organizimi ka një optimizim të pjesmarrësve dhe nga prezenca e një guide shkencore e aftë të kenaqë interesa dhe kuriozitetet të ndryshme. Rezultatet më të mira janë të lidhura me ekipe të docentëve të perbërë nga biologë, kimistë, gjeologë botanistë, ekollogë ekspertë antropologë.

### **Konkluzione**

Të qëniti ekolog në Shqipëri, në fillimet e viteve '90 kohë e rënies së komunizmit, është e lidhur me problemet e vështrësive të një kulture të re, si në fushën e kërkimit shkencor ashtu edhe në ato didaktike, të edukimit ambjental. Ekologët profesionistë, në fakt kanë patur avantazhet dhe disavantazhet e tyre sepse, kanë qënë në një fushë të një disiplinë shkencore teorike dhe të aplikuar, ku u duhej të konfrontoheshin me një sërë pyetje dhe informacione që ishin pjesë, fatkeqësisht të lidhura me shoqëri vullnetare dhe të improvizuara të çdo tipi. Vështrësia e suksesit që finalizohet, me studime të mirefillta ekollogjike të dokumentuara, si dhe nga shumë inisiativa, është ti bëjnë rezistencë edhe atyre që janë nga brenda Universitetit. Kështu në kurse të Shkencave Natyrore ka edhe materiale teorike për ambjentin, të vjetëruara, të para më tepër në aspektin e përshkrimit të Ambjentit se sa në atë të përshkrimit të problemeve reale të ambjentit.

E gjitha kjo e shoqëruar nga heshtja dhe debulesa ndaj një rezistence të fortë nga lobe "opozitare" ndaj ambjentit, të cilat kanë kontribuar në shkatërimin e tij. Në situatën aktuale, të rritjes së ekollogjisë si shkencë, është e nevojshme të spostohen problemet në didaktikën e saj, që ka pikërisht karakteristikat e një discipline që kërkon përdorimin e metodave alternative për kthimin në shkencë tradicionale. Lind në këtë mënyrë nevoja për të inkluduar në programet e një shoqërie shkencore eksperimentimin didaktik mbi ambjentin në të gjitha nivelet dhe të ketë mbështetje në aspektin universitar. Me interes do të jene rruget që të hapin Fakultetin e Shkencave prezenca e kërkuesve që vijnë nga sektori shkencor. Eksperiencia e maturuar lejon të këmbëngulësh në disa pika që u shprehen në paragrafet e mëparshme. E rëndësishme është rekuperimi i shkencave sistematike dhe diagnostikimi i tyre në terren, pa këto do të jetë e pamundur çdo lloj analize.

### **Rekomandime**

Për këtë qëllim është e nevojshme të rivlerësohet institucione akademike paralele me ato universitare, shpesh të lena pas dore siç janë kopshtet botanike, muzetë natyrore, parqet natyrore të cilat duhet të shndërrohen në laboratore të hapur dhe vende ku mund të konceptohet ambjenti. Situta që kalon vendi im, është për të ardhur keq që, ne sot reflektojmë shëmbullin e vendit që redukton sipërfaqen e kopshtit të vetëm botanik që

kemi, kthejmë në zona urbane parqet natyrore, dhe shkatërrohen muzetë natyrore. Kjo sjellje është një antikap i vërtetë ndaj asaj që duhet të konsolidojme ato që kemi dhe të arrijmë ato që kanë të tjerët. Egzistenca e tyre në parametra shkencorë kontribon në formimin e përhapjen e kulturës natyralistike. Didaktika ekologjike thekson edhe pabarazinë e përgatitjes së specialisteve, që duhet të zëvendësojnë kulturën e përgjithshme, fleksibile, të gatshme për të futur elementë të rinj të një kulture preventivuese në drejtim të ambjentit. Krahas didaktikes ekologjike dhe media e shkruar, si mjet thelbësor komunikimi do të kishte një rol të rëndësishëm. Është e rëndësishme që të ketë një shkolle nacionale për gazetarinë shkencore, për dy nivelet të të mësuarit: për atë që nuk di gjë fare, për atë që ka një nivel shkencor të kenaqshëm. Kujtojmë se kërkimi shkencor dhe marrja (blerja) e vërtetës janë praktika sterile që, nëse nuk shpërndahen në mënyrë kapilare, nuk kontribuojnë në mireqënien e komunitetit. Nuk ka ekologji të natyrës pa ekologji të mendjes. Kësaj shprehje dhe këtij misioni duhet ti përgjigjet didaktika e shkencave natyrore në tëresi dhe didaktika ekologjike në veçanti. Ndonëse në dukje një koncept mjedisor, zhvillimi i qëndrueshëm, është një koncept tërësisht ekonomik që garanton sigurinë e zhvillimit ekonomik. Për të arritur këtë zhvillim, Shqipëria ka nevojë për një program veprimi i cili do të ndihmojë në:

- (i) përmirësimin e cilësisë së jetës
- (ii) krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar dhe
- (iii) integrimin e strategjisë mjedisor e me strategjitë e tjera sektoriale.

Informimi i publikut mbi gjëndjen reale të mjedisit duhet të marrë një rëndësi vendimtare në programin mjedisor të qeverisë. Shoqëria civile dhe organizatat e pavarura e të specializuara të ftohen të kontribuojnë në hartimin e politikave mjedisore, në zbatimin e tyre, si dhe veçanërisht në monitorimin e gjëndjes së mjedisit. Edukimi i publikut do të mbështetet nga programe specifike që do të realizohen në bashkëpunim me shoqërinë civile. Duhet të rishikohen të drejtat ligjore të publikut dhe do të përmirësohen procedurat e ankimit administrativ dhe gjyqësor për t'i dhënë akses më të lartë grupeve pro-mjedisore të kërkojnë mbrojtjen e mjedisit dhe ndëshkimin e ndotësve në rrugë administrative e gjyqësore.

#### **Literatura**

- Bejtullahu R., Bicaj M., Rustemi R. (2011): Njeriu dhe Natyra3; 6, 26;
- Mustafa B. (2007): Ekologjia dhe Mjedisi 5-6; 13-15,17,19, 39-40,51,57, 60-62;
- Hyseni M., Matthies P. (2011): Qershor, Anash approaching science, analet e Alb-Shkencës Viti VI, Nr.8; 15-18
- S. Kose, G. Akkus, K. Gezer. (2014): Computer Assisted Concept Maps Instruction: Effects on Overcoming 6th Grade Students Misconceptions of Learning the Circulatory System, *Journal of Environmental Protection and Ecology (JEPE)*, Vol. 15, No. 2, 733
- F. T. Unal. (2014): Importance of Nature Visuals in Improving Writing Skills, *Journal of Environmental Protection and Ecology (JEPE)*, Vol. 15, No. 2 742
- H. Bancheva. (2015): Methodology for Multi-day Tourism in 'Vrachansky Balkan' Nature Park as a Contribution to the Education for Sustainable Development, *Journal of Environmental Protection and Ecology (JEPE)*, Vol 16 no 1, 298